

Urdhër nr.254, datë 10.4.2020 “Për protokollin e funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, në situatën e pandemisë së covid-19”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror në RSF”, dhe të VKM-së nr.243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, MSHMS miratoi këtë urdhër i cili ngarkon Shërbimin Social Shtetëror, strehëzat për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, bashkitë për zbatimin e tij.

Duke qenë se eksperiencia botërore paraqet fakte të mundësisë së rritjes apo përshkallëzimit të dhunës në familje në kushte të distancimit social dhe izolimit të detyruar, si dhe nisur nga disa raste të incidenteve të dhunës në familje të ndodhura gjatë muajit mars 2020 në situatën e emergjencës së COVID-19, përgatitja e protokollit për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, në situatën e pandemisë së COVID-19”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, mori përparësinë e duhur.

“Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat” është i vlefshëm vetëm në kushtet e emergjencës së COVID-19 (por mund të përdoret si referencë në kushte të emergjencave të ngjashme të sëmundjeve infektive e pandemive, duke përditësuar pjesë të caktuara të tij në varësi të llojit të sëmundjes dhe masave përkatëse që do ndërmerren nga shteti për përballimin e saj). Ai nuk shfuqizon standardet dhe procedurat e funksionimit të qendrave rezidenciale publike e jopublike që ofrojnë shërbime të specializuara të strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, zbatimin e të cilave mbetet i detyrueshëm në situatë joemergjence.

Në urdhër vihet në dukje fakti se shqetësim më të madh përbëjnë grupe të caktuara të grave si: gratë me aftësi të kufizuara, gratë emigrante apo azilkërkuese të pa pajisura me dokumente dhe gratë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore. Studimet e deritanishme, bazuar dhe në eksperiencat nga përballja me pandemi të mëparshme, tregojnë se grupet më të rrezikuara në këtë situatë të pandemisë së COVID-19 janë ata që për të siguruar jetesën varen shumë nga ekonomia informale, si dhe që kanë qasje të kufizuara në shërbime sociale apo në teknologji. Kështu, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, personat e infektuar apo që jetojnë me virusin HIV, personat me statusin e refugjatit, migrantit apo azilkërkuetit, të moshuarit, personat që aktualisht jetojnë në kushtet e një dëmtimi të

mëparshëm të një situatë të emergjencës civile, personat nën mjekim të vazhdueshëm, minoritetet etnike apo personat LGBTI, renditen ndër më të cenuarit në këtë situatë.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/04/10/254/ee688490-ab32-4bf0-8e1e-cb31ba575392>